



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republike of Kosovo  
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality  
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

**KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH**

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, dhe nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ, Nr-27/2012, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, pas propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.03.2026 miraton këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

**MIRATOHET** Plani Vjetor i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2026.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës dhe Plani i Veprimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2026, i hartuar nga Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi z. Adem Emini në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Dragash.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës z. Bexhet Xheladini, njëherit Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi z. Adem Emini.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

01Nr. 060/01-4615-1/26  
Datë 31.03.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Resul Fetahu  
